

REPUBLIKA E SHqipëRIE

**MINISTRIA E
BUJQËSISË,
ZHVILLIMIT
RURAL DHE
ADMINISTRIMIT TË
UJËRAVE**

**QËNDRA E TRANSFERIMIT TË TEKNOLOGJIVE BUJQËSORE
VLORE**

PROJEKT: KËRKIM NË FERMË

RAPORT – PERFUNDIMTAR

Titulli i projektit:

“Krasitja prodhuese ne ulli”

Afati i zbatimit viti 2013

Drejtues projekti

Adhurim Lazaj

TITULLARI

Dr Aulona Veizi

Rëndësia e një praktike të tillë është e njohur që nga kohët antike. Si autorë grekë ashtu edhe latinë e përmendin krasitjen si një ndër shërbimet kryesore në kultivimin e ullirit. Në rrjedhën e shekujve teknika e krasitjes së ullirit ka pësuar një evolucion në korrelacion me zhvillimin e përgjithshëm të shoqërisë. Moretini e përkufizon krasitjejen si “Artin e modifikimit të formës natyrale vegetative të pemëve të kultivuara me qëllim të marrjes rendimentin më të lartë.”

Krasitja e ullirit bëhet për të rinovuar elementët prodhues, eliminuar pjesët e thata dhe të dëmtuara, favorizimin e depërtimit të dritës dhe ajrit, kontrollimin e rritjes vegetative duke ruajtur dimensionet dhe formën e bimes, zvogëlimin e alternances së prodhimit, dhe shmangien e demtimit nga parazitët.

Krasitja lejon që nëpërmjet mjeteve të posacme të prerjes, të heq lastarë për të favorizuar zhvillimin e degëve frutore, të ndërhyjë duke modeluar formën e bimes për rregullimin e rritjes dhe të sjelljes në bazë të nevojave kulturele dhe në shpërndarjen homogjene të drites mbi të gjitha pjesët e bimës. Qëllimi i gjithë këtyre ndërhyrjeve është favorizimi i pridhimitarisë duke mbajtur një zhvillim të ekuilibruar të pemes.

Janë të shumta kërkimet e bëra në dekadat e fundit për të vlerësuar efektin e metodave të ndryshme të formave dhe të krasitjes. Në opinionin e sotëm mendimi që mbizotëron është ai që lidhet me teknikat më operative që koordinojnë lidhjen midis nevojave fiziologjike të ullirit me faktorët social, teknike dhe ekonomike të prodhimit. Duke pasur parasysh rezultatet e arritjeve të kërkimeve shkencore dhe problematikave të ullahteve tona gjatë këtij kërkimi është tentuar që në të gjitha vendet ku u krye ky kërkim të përcillej tek fermerët eksperiencë më e mirë e krasitjes prodhuese si dhe të evidentonim praktikisht edhe të rehat e kërkimit baza e të cilit ishte në këto aspekte principale:

-Në përshtatjen e formës së mbajtjes në ‘vazo polikonike’ duke bërë zëvendësimin gradual të formave të tjera aktuale pasi kjo formë është e njohur si forma më e sigurtë për ulliritin dhe më efiçiente për prodhimin në bazë të një serie vlerësimesh e eksperimentesh.

-Në ekonomizimin e procesit të krasitjes me tendencën e zvogëlimit të punës së krahut duke shtuar pajisje më të sofistikuara dhe përdorimin e mekanikes.

-Në aplikimin e krasitjeve elastike duke evituar nderhyrjet shumë të rënda.

Objektivi i kërkimit

Duke pasur parasysh rritjen e sipërfaqeve të mbjella me ullahte si dhe interesin gjithnjë në rritje për prodhimin në treg dhe për të tentuar të kalohet nga një ullahte margjinare, në modele kulturele më të përshtatshme aplikative ishte i nevojshëm ngitja e këtij

kërkimi . Qëllimi I tijë ishte te përcjellë tek fermeri teknikat më të përshtatshme të krasitjes prodhuese në ullishte, në përpjekje të rritjes së efektivitetit ekonomik të kulturës duke ulur koston e prodhimit. Krasitja së bashku me ujitjen e plehrimin janë proceset ku mund dhe duhet te fokusohet kerkimi për rritjen e prodhimit ne sektorin e ullishtarisë.

Materiali dhe Metoda

Kërkimi u ngrit ne tre pika te ndryshme ku ka siperfaqe në rritje të ullishteve dhe në bazë të interesit të shprehur nga fermerë në rrethet e Fierit, Elbasanit dhe Tiranës. Cdo rreth në fakt ka pasur specifikat e veta jo vetëm në lidhje me karakteristikat e zones por edhe të kultivarit te ullirit,moshes dhe nivelit agroteknik.

Në Qarkun e Fierit studimi u ngrit në fshatin Cakran në parcelën e fermerit Shezai Veizaj në ullishte të vitit të pestë të kultivarit Frantoio, në bashkinë Vorë të qarkut të Tiranës në fshatin Maminas në fermën e Zenel Bylyku ne ullishte të kultivarit i Bardhi i Tiranës me moshë mbi 15 vjeçare dhe në qarkun e Elbasanit në fermën e Agron Tabakut në Komunën Qëndër në ullishte mbi 50 vjeçare.

Projekti u udhëhoq nga specialistët; A. Lazaj, E. Brahimsulaj R.Merkohitaj,në bashkëpunim me D.R.B.U.M.K.Tiranë perfaqësuar nga Z . Zyhdi Cuhllai, ekstensionisti I ngarkuar z. Azir Hykaj D.R.B.U.M.K.Elbasan nga ekstensionisti Neshat Sadiku si dhe D.R.B.U.M.K. fier perfaqesuar nga Z. Et'hem Bitaj dhe ekstensionisti Bekim Beshaj qe meritojne nje falenderim per punen e bere.

Në të tre parcelat është bërë krasitja e pesë bimëve duke tentuar te bejme përshtatjen e formës së krasitjes neatë të ‘vazo polikonike’ , jane perdorur mjete të krasitjes duke filluar qe nga gershera, sharra, sepata e deri tek sharra motorrike në pamundësi për demonstrim tëp resave pneumatike të mjeteve motorrike.

Gjatë krasitjes u synua të bëhej krasitje korrekte dhe në kohë sa më të shkurtër për të evidentuar kohën e nevojshme për një krasitje efektive,

Para krasitjes u bë matja e lartësisë dhe gjerësisë së kurorës duke e përsëritur këtë matje pas krasitjes Duke njohur dhe kushtet klimatike te zonave dhe duke pare dhe terrenin sipas fermave per çdo rast u percaktua mbas matjes se kurores lartesia dhe diametric qe bima do te kishte mbas krasitjes duke synuar ne arritjen e kurores optimal ne fermën e Fierit, ne reduktimin e lartesisë se kurores nga 5-6 metra ne 4 metra ne fermet e Elbasanit dhe te Vores si dhe te sensitetit ne te tre rastet $2m^2$ per çdo m^3 kurore.



Foto të momenteve të ngritjes së provave në të tre fermerat

Rezultatet:

Mbështetur në metodikën e hartuar, rezultatet e studimit jepen nëpërmjet treguesve të marrë që janë lartësia e kurorës dhe diametri i saje, paraqitur në tabelën e mëposhtme e konvertuar në vëllimin e kurorës.

Tab.1. Përmbledhëse e treguesve kryesorë të rritjes

Krasitja sipas qarqeve	Vëllim i kurorës (prill) në m ³		Vëllim i kurorës (nëntor) në m ³	Rritja e vëllimit të kurorës %
	Para krasitjes	Pas krasitjes		
Cakran	33.18	31.84	41.74	31.09
Vore	114.8	85.34	92.30	8.15
Elbasan	128.5	88.25	93.95	6.45




foto nr.5. Paraqitja e rritjes së vëllimit të kurorës në të tre fermerat.

Në metodikën e hartuar për këtë kërkimnjë tjetër faktor që ishte planifikuar në studim ishte edhe sasia e prodhimit të marrë nga bimët e krasitura. Por ky vit ishte një vit me prodhim të limituar për shkak të periodicitetit që manifeston kjo kulturë dhe rezultatet e marra nuk u morën në konsideratë nga ana jonë pasi sasi të ishin shumë të vogla. Ky tregues së bashku me të rjerat do të ishte me interes të krahasoheshëm vitin në vazhdim.

Vlerësimi i rezultateve: opinionet e fermerëve dhe ekstensionistëve.

Gjatë kohës së realizimit të studimit, te tre fermeret ku është ngritur studimi megjithëse kanë qenë mjaft të interesuar grupi i punës ka evidentuar një mungesë të njohurive për konceptet bazë të krasitjes e manifestuar kjo edhe në mënyrën e krasitjes së ulla në tyre. Kjo nxjerr edhe njëherë në pah thënien se për të prerë mund të presin të gjithë por të krasitin nuk është e lehtë. Nga rezultatet e madhësive së kurorës në fshatin Cakran është evidentuar një rritje më e lartë se në dy fermat e tjera, por kjo sqarohet me faktin se ulla është e re dhe ka një potencial më të madh të aftësisë rritëse, por edhe të pjellorisë së tokës.

Vlerësimi dhe efektiviteti ekonomik: llogaritja e shpenzimeve dhe të ardhurave.

Nëse do të bënim një vlerësim ekonomik ne do të bënim thjeshtnjë llogaritje të kostos së krasitjes për çdo rast pasi një vlerësim I përafert do të bëhej nëse ky kërkim do të bëhej të pakten për tre-kater vjet dhe në këtë rast mund të diskutonim edhe për efektivitetin ekonomik.

7. Diskutime dhe konkluzione:

Pa dashur të përsërisim ato që u thanë më lartë mund të themi se është e nevojshme që me demonstrime dhe takime e pse jo nëse është e mundur edhe me kurse trajnimi të kontribuohet në të ardhmen për ngritjen profesionale të grupeve të shumta të krasitësve.

Për të bërë një vlerësim më të mirë të rezultateve të krasitjes së këtij viti është mirë që kërkimi të vazhdojë edhe në vitet në vazhdim pasi vetëm me të dhënat e këtij viti nuk mund të arrijmë të japim rekomandime të dala nga ky kërkim.

9. Përhapja (propagandimi) i rezultateve.

Si formë rezultative e përhapjes së kësaj eksperience, do të ishte planifikimi i demonstrimit të krasitjes prodhuese me fermerë kultivues të ulla. Demonstrimi mund të organizohet edhe në shkallë qarku me fermerë të zonës ose dhe më gjerë por edhe në organizimin e kurseve të trajnimit nëse ka interes nga fermerët.

Në realizimin me sukses të projektit, meritë kanë gjithë stafi i projektit, e veçanërisht, specialistët e D.R.B.U.M.K. z. Zyhdi Cuhllai, z. Et'hem Bitaj, z. Neshat Sadiku z. Azir Hykaj e z. Bekim Beshaj që me impenjimin dhe angazhimin e admirueshëm të tyre si

dhe , fermerët z. Shezai Veizaj , z. Zenel Bylyku dhez. Agron Tabakut me gatishmërinë dhe lehtësirat e krijuara për ngritjen e studimit.

Literatura e përdorur

- 1- A.R.S.I.A. 2002. Regione Toscana. La potatura dell'olivo in Toscana. Riflessione tecniche. (17).
- 2- A.R.S.I.A. Nuovi sistema di coltivazione dell'olivo. Aspetti agronomici, economici e qualitativi.
- 3- ARUSTIA.Perugia. 2002. Tecnice per lo sviluppo del'olivicultura in Umbria.
- 4- Cantini,C,and B, Sillari. 1998.Risultati produttivi ed economici di oliveti condotti con diversi sistema di potatura. Riv. Fruticoltura,70(1);49-54.
- 5- Cantini,C,Gucci, R, and B, Sillari. An alternative method to managing Olive Ochards the coppiced system.
- 6- Cimato, A. C, Cantini, and B. Sillari.1990. a method of pruning for the recovery of olive productivity. Acta Hort. 286; 251-254.
- 7- Del Rio C.et al . 1994 Preliminary agronomical charaterization of 13 cultivars introduced in the olive germoplasm bank of Cordoba in March 1987. Acta hort.
- 8- Fontanazza, G. 1993 Olivicultura intensiva specializzata. Edagricola, Bologna.
- 9- Ismaili, H. Veshaj,Z. 2002. Ullishtaria Istituti i Pemetarise Vlore.
- 10- Kafazi,N. Muco, Dh, 1984. Kultura e Ullirit.
- 11-Preziosi P,,P Proietti, F. Famiani, and B,Alfei. 1994.Comparison betëeen monocone and base training systems on the olive cultivars Frantoio, Moraiolo and Nostrale di Rigali. Acta Hort.356
- 12- Thomaj F.2009. Shtimi&Mirembajtja e ullishteve (manual)
- 13- Thomaj F, Panajoti,Dh,2005.Kultivimi i ullirit.(manual)
- 14- Tous, J,2008. Nuove tendenze e modelli per l'olivicultura mondiale.

Drejtuesi i projektit

TITULLARI

Adhurim Lazaj

Dr Aulona Veizi

Enver Brahimsulaj

Ramo Merkohitaj

